

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajt Qershor 2024

Lufta kundër korrupsionit dhe reformat e parashikuara në kuadrin strategjik prezantohen në takimin e Këshillit Kombëtar të Integritit Evropian

03.06.2024: Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni iu përgjigj thirrjes për raportim të Këshillit Kombëtar të Integritit Evropian për paketën e reformave në administratën publike dhe luftën kundër korrupsionit. Ministri Pirdeni në ushtrim të rolit të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit informoi anëtarët e Këshillit, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të institucioneve publike, të organizatave të shoqërisë civile, sektorit privat, universitetit dhe medias mbi rezultate të reformës kundër korrupsionit në administratën publike dhe hartimin e kuadrit të ri strategjik të fushës. Nën drejtimin e tij dhe me ekspertizën teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit janë koordinuar masat për mbledhjen dhe ndjekjen e sinjalizimeve të qytetarëve për raste korrupsioni në organet e administratës publike ku përmenden 1700 denoncime dhe kërkesa (për periudhën vjetore 2023-maj 2024), të cilat janë konkluduar në propozime për masa disiplinore, ndryshime ligjore dhe në 48 kallëzime penale. Ministri Pirdeni konfirmoi përgatitjen e disa marrëveshjeve të bashkëpunimit, përkatësisht me Agjencinë e Prokurimit Publik, të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe organin e prokurorisë, si koordinim i masave për ndërhyrje. Rishikimi i kuadrit të ri strategjik kundër korrupsionit do të ketë risi targetimin përmes masave specifike të sektorëve më të ndjeshëm ndaj korrupsionit, duke përmendur pronësinë, taksat, tatimet, e prokurimin publik. Nën mentorimin e ekspertizës së Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit është rritur numri i instrumenteve institucionale të integritetit në nivelin qendror, si masa mbrojtëse ndaj risqeve të korrupsionit në aktivitetin e përditshëm politikë dhe teknikë të autoriteteve publike. Ministri njëkohësisht Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit Pirdeni, konfirmoi gjithashtu punën përgatitore të kryer për adresimin e 19 nga 24 rekomandime, të ngelura për zbatim, dhe për të cilat do të shprehet GRECO, në muajt në vijim.



Seancën dëgjimore të kryer pranë Këshillit Kombëtar të Integritit Evropian mund ta gjeni në link: https://www.facebook.com/watch/live/?ref=watch_permalink&v=286904254411822




Takimi i 12-të i PAR SG, BE-Shqipëri merr në shqyrtim të dhënat e luftës kundër korrupsionit në administratën publike

27.06.2024: Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni kryesoi delegacionin e qeverisë shqiptare në punimet e takimit të 12-të të Grupit të Posaçëm për Reformën në Administratën Publike, BE - Shqipëri. Ekipi shqiptar i drejtuar nga ministri Pirdeni dhe i përbërë nga zyrtarë të nivelit drejtues, të lartë teknikë, zhvilluan në Bruksel raportimin e politikave dhe veprimeve të kryera përgjatë qershor 2023 - maj 2024 në drejtim të mirëqeverisjes, luftës kundër korrupsionit dhe reformës në menaxhimin e financave publike. Takimi u zhvillua i kërkuar nga zyrtarët e Komisionit Evropian. Reformimi i kuadrit strategjik kundër korrupsionit, masat e planit të veprimit kundër korrupsionit për tre vitet e ardhshme, 2024-2026, përparimi me instrumentet e integritetit në nivel qendror dhe vendor, promovimi i indekseve të transparencës së autoriteteve publike, promovimi i masave të bashkëqeverisjes dhe adresimi i ndërhyrjeve për mbrojtje të qytetarëve për raste korrupsioni të zyrtarëve publikë. Zyrtarët e DG NEAR dhe institucione të tjera të BE, morën informacione të detajuara nga zyrtarët shqiptarë për kuadrin strategjik në pritje për tu miratuar, të luftës kundër korrupsionit, për procesin e kryer, përbajtjen e masave për ndërhyrje dhe mbështetjen buxhetore të planifikuar, përkatësisht. Ekipi Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit shoqëroi ministrin Pirdeni dhe asistoi në përgatitjen e informacionit teknik, duke vënë në dispozicion të Komisionit Evropian të dhëna dhe informacione raportimi.

Këshilli i Ministrave unifikon njësinë teknike të politikë-bërjes dhe hetimit administrativ kundër korrupsionit

26.06.2024: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit – DPAK, do të funksionojë tashmë si një entitet publik më vete. Njësia qendrore e politikë-bërjes kundër korrupsionit dhe njësia ku do të qendërohen ndërhyrja e masave të hetimit dhe verifikimit administrativ për raste korrupsioni në administratën publike është ngritur, organizuar për të funksionuar si një njësi administrative me strukturën e saj teknike dhe të shërbimeve mbështetëse. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.436, datë 26.6.2024, "Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit", rregullon varësinë juridike të kësaj strukture nën ministrin përgjegjës për antikorrupsionin, njëkohësisht Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit. DPAK është struktura teknike me profilin më të lartë të hartimit të politikave, programeve dhe projekteve në fushën kundër korrupsionit, komunikimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e shoqërisë për luftën kundër korrupsionit. DPAK do të kryejë hetime administrative me marrjen e denoncimeve ose ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për veprime dhe/ose mosveprime nga punonjësit e administratës publike. Këtë funksion DPAK do ta kryejë së bashku me koordinatoret kundër korrupsionit që janë në 26 institucione dhe agjenci publike, që ofrojnë dhe japin shërbime për publikun. Këto njësi i përkasin sektorëve të prokurimit publik, të shëndetësisë, mjedisit, bujqësisë, kadastrës, kontrollit ushqimor, tatime dhe doganave, arsimit, shëndetësisë, kontrollit të territorit, shërbimeve sociale dhe pranë qendrave spitalore. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit është njësia me ekspertizën teknike që do të përfaqësojë shtetin shqiptar në të gjithë iniciativat për bashkëpunim me autoritete homologe të fushës jashtë vendit dhe së bashku me ministrin e linjës në udhëheqjen e negociatave për integrimin evropian me fokus luftën kundër korrupsionit.



Vendimin e plotë të Këshillit të Ministrave për DPAK mund ta gjeni në link: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2024/107/a86431a8-f9cb-477f-8340-c8daaab64bbe>



Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030 drejt finalizimit teknik

11- 14.06.2024: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka zhvilluar një cikël të ri konsultimesh teknike për strategjinë e re të luftës kundër korrupsionit, për vitet 2024-2030. Në datat 11-14 qershor 2024 janë zhvilluar 8 takime teknike me fokus diskutimin e masave e aktiviteteve të planifikuara për tu zhvilluar dhe përfshirë në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe gjithashtu konsolidimin e treguesve të performancës që do të shërbejnë si matësit e rezultateve të pritshme për objektivet specifike me kohë zbatimi vitin 2030. Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, ka hyrë në fazën finale të përgatitjes së saj (para miratimit) dhe grupi i punës pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit ka diskutuar përmbyajtje teknike të saj. 8 takime pune me (1) të gjitha ministrinë e linjës, (2) agjencitë përgjegjëse për pronat, sektorin e arsimit, sektorin e shëndetësisë, prokurimin publik dhe partneritetin publik-privat, doganat dhe tatimet, (3) Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe agjencinë përgjegjëse për marrëdhënie me pushtetin vendor, (4) autoritetet përgjegjëse për deklarimin e pasurive, (5) kontrollin dhe funksionimin e administratës publike, trajnimin




e administratës publike, (6) autoritetet përgjegjëse për transparencën e informimin, shërbimet elektronike si dhe bashkëqeverisjen, (7) Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si dhe (8) autoritetet ligjzbatuese, prokuroritë, Policia e Shtetit, AAPSK, Shkolla e Magjistraturës, ku janë diskutuar detajet e përmbajtjes së strategjisë. Strategjia e re Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit do të ketë 3 qëllime politikash me fokus parandalimin e korrupsionit dhe orientimin e mekanizmave parandalues, 17 objektivë specifikë që do të prekin të gjithë instrumentet e luftës kundër korrupsionit që BE dhe SHBA i ka kërkuar Shqipërisë dhe 60 masa, për veprim dhe ndërhyrje. Strategjia e re Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit do të nënshtrohet brenda muajit korrik 2024 procesit të konsultimit publik për më shumë gjithëpërfshirje grupesh interesi.

Draftin e plotë të dokumentit strategjik, të shpallur për konsultim publik mund ta gjeni në link: <https://konsultimipublik.gov.al>

Programi HELP i Këshillit të Evropës, një mundësi e shtuar trajnimi për stafin teknik të antikorrupsionit

07.06.2024: Kursi “Hyrje në parandalimin e korrupsionit” do të mundësohet dhe ndiqet edhe nga stafi dhe ekspertët e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit. Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë së bashku me Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, promovuan këtë nismë në kuadër të Programit HELP, duke krijuar hapësirë teknike Shkollës Shqiptare të Administratës Publike të mundësojë këtë kurs për këtë grup teknikësh. Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit dhe Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion, do të ndjekin 13 module të programit, me një kohëzgjatje prej 12 orësh. Modulet dhe vlerësimi i kursit do të zhvillohen nga data 10 Qershor 2024 - 12 Korrik 2024. 13 modulet e kursit do të konsistojnë në rritjen e ndërgjegjësimit mbi format e korrupsionit dhe mjetet e parandalimit të tij, kodet dhe sjelljet etike, konfliktin e interesit dhe mënyrat e menaxhimit të situatave të tilla, qëllimin dhe përforsimin e kufizimeve pas largimit nga detyra, rregullimin e menaxhimit të dhuratave, qëllimin e sistemeve të deklarimit të asetëve dhe konfliktit të interesit, rolin e qasjes së lirë në informacion në parandalimin e korrupsionit, rregullimin e lobimit, transparencën e financimit të partive politike, mbrojtjen e sinjalizuesve, risqet e korrupsionit në prokurimin publik dhe masat mitiguese, si dhe rolin e auditit në luftën kundër korrupsionit. Nëpërmjet shembujve dhe skenarëve praktikë, kursi vë në vëmendje dilema etike dhe sfida të zbatimit faktik të masave antikorrupsion. Kursi si një mjet elektronik autodidakt, i përkthyer dhe përshtatur me kuadrin ligjor dhe institucional shqiptar, do të mentorohet nga dy ekspertë të Këshillit të Evropës. Në përfundim të kursit pjesëmarrësit do të kenë certifikatat e pjesëmarrjes. Kursi vjen si një eksperiencë shumë e mirë e ndjekur më parë edhe nga këshilltarët politikë të ministrave.




Platforma II Rajonale Antikorrupsioni dhe Financimi i Paligjshëm hartohet dhe miratohet në Tiranë

25-27.06.2024: Platforma e II-të Rajonale Kundër Korrupsionit dhe Financimi i Paligjshëm u mbledh në Tiranë, në datat 25-27 qershor 2024. 6 vendet e Ballkanit Perëndimor Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia u bashkuan nën koordinimin e UNODC për të hartuar të dytin udhërrëfyes (*Roadmap*) që do të udhëheqë zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC). Stafet teknike të agjencive antikorrupsion, autoriteteve parandaluese me veprimtari në fushën e prokurimeve publike, konfliktit të interesave, integritetit, informimit dhe kualifikimit edukativ kundër korrupsionit si dhe organe ligjzbatuese si prokuroritë (të përgjithshme dhe të specializuara), policitë e shtetit, pastrimit të parave dhe administrimit dhe sekuestrimit të pasurive të krimit diskutuan dhe orientuan angazhimet e rajonit për luftën kundër korrupsionit dhe qeverisjes së mirë. Ky dokument (*roadmap*) do të ketë një shtrirje vitet 2024-2025, dhe parashikon angazhime të njëjta për të 6 vendet, duke garantuar monitorimin e tij për çdo vit zbatimi. UNDOC është struktura teknike që lehtësoi zhvillimin e këtij takimi të zgjeruar pune dhe mbështeti vendet për planifikime sa më konkrete dhe të qarta. Dokumenti (*roadmap*) Antikorrupsioni dhe Financimi i Paligjshëm, ka dy pjesë përbërëse: (I) Parandalimi i Korrupsionit dhe (II) Kriminalizimi, zbatimi i ligjit, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rikuperimi i asetëve. Parandalimi i korrupsionit evidenton nevojën për ndërhyrje dhe vijueshmëri thelbësore në kuadrin strategjik, edukimin dhe informimin e shtuar për mekanizma të luftës kundër korrupsionit, ndërhyrje në sektorin e prokurimit publik. Fusha e zbatimit të ligjit evidenton nevojën dhe ndërhyrje të mëtejshme në bashkëpunimin mes prokurorive dhe policive për hetimin penal dhe kualitetin e hetimeve, si dhe në promovimin e rikuperimit të asetëve. Platforma e II-të Rajonale Kundër Korrupsionit dhe Financimi i Paligjshëm, Tirana 2024 ishte një tregues i vullnetit politik dhe teknik për të avancuar me reformat antikorrupsion në Shqipëri dhe rajon.

Lufta kundër korrupsionit si temë diskutimi në forumin e hapur me të rinjtë

04.06.2024: Lufta kundër korrupsionit dhe angazhimi i të rinjve është kërkesë, nevojë dhe detyrë. Forumi “Fuqizimi i të rinjve në luftën kundër korrupsionit dhe rifitimi i besimit në integritet” i inicuar dhe organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit krijoi një mundësi komunikimi midis autoriteteve tona, publike, organizatave të shoqërisë civile dhe të rinjve për të folur dhe promovuar informimin kundër korrupsionit. Forumi u kthye në një platformë komunikimi për fuqizimin e të rinjve, për dialog, shkëmbim njohurish dhe bashkëpunim për mekanizmat e luftës kundër korrupsionit dhe denoncimin e tyre. Përfaqësues panelist i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit solli në vëmendjen e pjesëmarrësve të forumit nevojën për angazhim dhe rritje të ndërgjegjësimit të publikut tek institucionet publike. Fushatat e ndërgjegjësimit, edukimi i publikut kundër korrupsionit dhe përdorimi i komunikimit social për luftën kundër korrupsionit pritet të jetë edhe 1 prej 17 objektivëve të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Pjesëmarrësit në këtë forum u informuan edhe mbi kuadrin ligjor të sinjalizimit si dhe për rregullat dhe mekanizmat e kontrollit të përdorimit të fondeve publike. Zëri kritik i shoqërisë civile u përfaqësua nga organizata “Qëndresa Qytetare” që solli shembujt e saj të monitorimit ndaj rasteve të korrupsionit në sektorin e arsimit publik. Forumi është një rast i mirë bashkëpunimi që duhet të replikohet dhe ka gatishmëri të strukturës teknike antikorrupsion.



E-buletini “Antikorrupsioni” në tre-vjetorin e tij evidentohet si model i mirë komunikimi në NCPA

13.06.2024: E-buletini “Antikorrupsioni” ky mjet informimi dhe komunikimi mujor për punët dhe proceset e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit është kthyer në një platformë model për organizatën Rrjeti i Agjencive Parandaluese Antikorrupsion – NCPA. Pas një eksperiencë tre-vjeçare (qershor 2021 - qershor 2024) në shkrimin dhe shpërndarjen e e-buletinit mujor “Antikorrupsioni” nga Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit në përfaqësim të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, ky mjet komunikimi u evidentua dukshëm. Rrjeti NCPA në fillim të aplikimit të këtij moduli komunikimi proklamoi e-buletinin e Shqipërisë dhe riprodhoi një prej shkrimeve të tij (artikulli për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, publikuar në nr. 35, prill 2024) si një eksperiencë e mirë. Komunikimi, vizibiliteti dhe informimi për luftën kundër korrupsionit në radhët e grupeve të interesit i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit të Shqipërisë ka marrë në këtë mënyrë një notë vlerësimi duke i vendosur vlerë të shtuar këtij mekanizmi qendror. Lufta kundër korrupsionit njihet si shtyllë ku mund të mbështetet edhe komunikimin dhe edukimin e shtuar, në përputhje me politikën e III-të të kuadrin strategjik antikorrupsion të vendit.

Informacione dhe të dhëna për Rrjetin NCPA mund të gjeni në link: <https://www.coe.int/en/web/corruption/ncpa-network>